



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.Shk II.nr. 155/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS- Departamenti i Përgjithshëm, Dhoma e shkallës së dytë, me gjyqtaren Saranda Bogaj Sheremeti në çështjen përmbartimore të kreditorit “SEFERICO” Sh.P.K me NUI 810100537, me seli në Gjinoc, Suharekë, të cilin me autorizim e përfaqëson V.K. avokat nga Prizreni, kundër debitorit Komuna e Malishevës, me bazë juridike përmbartimore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës Dhomat e Shkallës së parë, KPPP.nr.152/23 të datës 29.11.2023, me datë 16.04.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e debitorit Komuna e Malishevës, me seli në Malishevë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës Dhoma e Shkallës së parë, KPPP.nr. 152/23 të datës 29.11.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale Dhoma e Shkallës së parë, me aktvendimin e atakuar KPPP.nr. 152/23 të datës 29.11.2023, në pikën I ka refuzuar në tërësi si të pa bazuar prapësimi i debitorit Komuna e Malishevës, ndaj Urdhrit Përmbartimor P.nr. 1527/22, i lejuar me datë 22.12.2022, nga Përmbartuesi Privat Mehdi Reshani, dhe në pikën II Urdhri Përmbartimor P.nr. 1527/22, i lejuar me datë 22.12.2022, nga Përmbartuesi Privat Mehdi Reshani, mbetet në fuqi.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë debitori, për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimi i gabuar i të drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Shkallës së Dytë, të aprovoj ankesën si të bazuar dhe të anulohet aktvendimi i Komerciale Dhomat e Shkallës së parë, KPPP.nr. 152/23 të datës 29.11.2023.

Kreditori ka ushtruar përgjigje në ankesë, me të cilën ka kërkuar që të refuzohet ankesa e kreditorit dhe të vërtetohet vendimi i shkallës së parë KPPP.nr.152/23 i datës 29.11.2023

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e debitorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori "SEFERI-CO" Sh.P.K., ka paraqitur propozim për përmbartim P.nr. 1527/22, i lejuar me datë 22.12.2022, me të cilin ka lejuar përmbartimin, në bazë të dokumenteve të besueshme: me nr. faturës nr.29 të datës 09.11.2022, faturës nr.30 të datës 10.11.2022 dhe faturës nr. 31 të datës 10.11.2022, duke urdhëruar debitorin që në emër të borxhit nga faturat e mësipërme t'ia paguaj kreditorit borxhin në shumë prej 72,613.29 Euro (shtatëdhjetë e dy mijë e gjashtëqindën e trembëdhjetë Euro e njëzet e nëntë cent), me kamatë ligjore prej 8 % duke llogaritur nga dita e dorëzimit të këtij propozimi për përmbartim të përmbartuesit privat me datë 21.12.2022 në llogarinë e kreditorit në Procredit Bank në numrin e kontos, në afat prej menjëherë nga dita e pranimit të urdhrin përmbartimor, si dhe të gjitha shpenzimet procedurale në emër të përpilimit të propozimit për përmbartim në shumë prej 208 (dyqindën e tetë) euro, si dhe shpenzimet tjera të krijuara në vazhdim të procedurës në llogari të avokatit V.K. në konto x NLB Banka nr.....

Debitori, brenda afatit ligjor, ka ushtruar prapësim duke e kundërshtuar në tërësi urdhrin përmbartimor duke theksuar se pasi faturat në emër të garancionit të punimeve nuk mund të ekzekutohen tani për shkak të kushteve të veçanta të kontratës sipas nenit 10.2, ku mbikëqyrësi ka qenë i obliguar të bëjë ndalesa të kësaj pagese në shumë prej 36,546.20 Euro 10 % të garancionit të punimeve. Tutje ka shtuar se kjo faturë nuk i plotëson kushtet për përmbartim sipas nenit 29 të

LPP-së, pasi që është në kundërshtim me LPP si dhe Ligjin për Prokurim Publik të Kosovës, pasi që nuk janë përcjellë procedurat e prokurimit publikë dhe nuk është në pajtim me kontratën që të bëhet kjo pagesë pasi duhet të pritët lidhur me garancionin e punimeve në afat prej një viti. Ka theksuar se faturat i ka ofruar kreditori për pagesë në Komunën e Malishevës në muajin nëntor të viti 2022 por të njëjtat nuk kanë mundur të ekzekutohen pasi që ka qenë mbyllja e vitit fiskal dhe sistemi i pagesave është mbyllur me datë 20 nëntor të viti 2022 dhe afati sipas ligjit të menaxhimit të financave publike për pagesën e faturave është 30 ditë kalendarike. Në fund ka shtuar se faturat e propozuara nga kreditori kanë qenë në procese të procedurave të shqyrtimit për ekzekutim dhe ka pasur afat ligjor ende për shlyerjen e tyre duke shtuar se kreditori sipas ligjit është dashur të kërkoj sqarim përse nuk është shlyer ky borxh, e jo të procedoj tek përmbaruesi dhe të kërkoj shpenzimet të pa nevojshme pasi nuk ka respektuar procedurat ligjore administrative për shlyerjen e këtij borxhi. Gjykatës i ka propozuar që urdhrin për përmbarim ta anuloj ose ta pezulloj si të pa bazuar.

Kreditore brenda afatit ligjor ka paraqitur përgjigje në prapësim, duke kundërshtuar në tërësi pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim, duke qenë e paqartë se cilat fatura i kundërshton, duke mos cituar numrin e faturës, por citon vetëm shifrën financiare, pa u ditë se cilat fatura i kundërshton, sidoqoftë në arsyetim në prapësim për kundërshtim debitori edhe pse nuk e ka cekur faturën cilën e kundërshton është fokusuar në shumën financiare prej 36,546.20 Euro, e cila rezulton të jetë e njëjta me faturën nr.30 të datës 10.11.2022 e pranuar në komunë me nr.protokoli 03/953, e cila përmban shumën e njëjtë si të kësaj fature. Tutje ka shtuar se sipas arsytimit të debitorit, kjo shumë financiare (bëhet fjala për shumën prej 36,546.00 Euro) nuk mund të realizohet, sepse po bëhet fjalë për pjesën e 10 % e cila shumë është e ndaluar për momentin në emrin e garancionit të punimeve në afat prej 12 muajve, ku në vazhdim deklaron se nuk ka kaluar ende periudha 12 mujore si periudhë e garancionit, sigurimit të punimeve. Ka cekur se debitori ka shfaqur një pretendim të pavërtetë, apo thënë ndryshe, vetëm sa për të kryer obligimin zyrtar për të paraqitur një kundërshtim për propozimin e lejuar, edhe pse e di që nuk ka bazë faktike për një gjë të tillë. Si provë ka bashkangjitur kopjet e policave të sigurimit: policës 108334 të datës 10.11.2022 për shumën financiare 36,580.12 Euro dhe shumë 3 financiare prej 3,647.23 Euro, me të cilat i ka propozuar gjykatës që origjinalet e tyre ti kërkoj zyrtarisht nga debitori, sepse të njëjta janë dorëzuar te debitori pasi që polica e sigurimit bëhet vetëm një kopje, andaj ka qenë e pamundur për të siguruar origjinalin. Sa i përket pretendimit të debitorit se nuk janë zbatuar procedurat administrative, ka shtuar se kjo nuk qëndron sepse në momentin e ekzistimit të

kontratës apo aneks kontratës si në këtë rast, rezulton një çështje e përfunduar të prokurimit, dhe në këtë fazë nuk vijnë në shprehje këto deklarata, pasi që kjo nuk është procedurë administrative për paraqitjen e ankesës, por jemi në fazën e procedurës përmbarimor. Gjykatës i ka propozuar që ta refuzoj prapësimin si të pabazë, si dhe ka kërkuar ti kompensohen shpenzimet procedurale.

Gjykata Komerciale Dhomat e Shkallës së Parë duke vendosur lidhur me pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, gjeti se prapësimi i debitorit është në tërësi i pabazuar andaj, të njëjtin e refuzoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, për shkaqet si në vijim: Sipas nenit 29, paragrafi 1 i LPP-së, “Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”, ndërsa, pika 1.3 e të njëjtit nen përcakton faturën si dokument i besueshëm sipas të cilës mund të caktohet përmbarimi për realizimin e kërkesës në të holla. Tutje, sipas paragrafit 3, të nenit 29 të LPP-së, “Dokumentit i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”, ndërsa, sipas nenit 37 të LPP-së: “Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit”.

Gjykata Komerciale Dhomat e Shkallës së Parë ka vlerësuar se urdhri i lejuar nga ana e përmbaruesit privat bazohet në dokumente të besueshme - faturën nr.29 të datës 09.11.2022, faturën nr.30 të datës 10.11.2022 dhe faturën nr. 31 të datës 10.11.2022 fatura këto të cilat i përmbajnë të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm në kuptim të nenit 29, paragrafi 3 të LPP-së, për arsye se në to janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë emërtuar mallrat me të cilat është shërbyer debitori, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi. Tutje, gjykata gjen se të njëjtat fatura janë dorëzuar në mënyrë të rregullt nga ana e kreditorit, ndërsa debitorit të njëjtat i ka pranuar duke i nënshkruar dhe vulosur, rrjedhimisht debitori ka qenë i njoftuar me detyrimin që rrjedh nga to. Poashtu, nga shkresat e lëndës rezulton se faturat mbi bazën e të cilave është lejuar urdhri përmbarimor, i plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 37 të LPP, për zbatimin e përmbarimit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi që të njëjtat janë dorëzuar në origjinal dhe mbajnë nënshkrimin e pranimit nga ana e debitorit.

Po ashtu gjykata e shkallës së parë gjen se debitori përmes prapësimit e ka pranuar borxhin duke theksuar se faturat nuk kanë mundur të ekzekutohen me arsyetim se ka qenë mbyllja e viti fiskal dhe sistemi i pagesave ka qenë i mbyllur me datë 20 nëntor 2022. Për gjykatën kjo nënkupton se debitori e ka pranuar detyrimin që rrjedhë nga faturat, rrjedhimisht i ka pranuar faturat si dhe nuk ka ofruar dëshmi se të njëjtat i ka kundërshtuar. Ndërsa, pretendimin se debitori ka qenë i obliguar të bëjë ndalesa të kësaj pagese në shumë prej 36,546.20 Euro në emër të 10 % të garancionit të punimeve, gjykata e mori si të pabazuar, për faktin se kreditori në përgjigje në prapësim ka njoftuar gjykatën se ka paguar garancionin në emër të shumës së pretenduar e që vërtetohet nga dëshmitë e bashkëlidhura në përgjigje dhe atë garancionet e realizuara pranë Kompanisë së sigurimit ELSIG të datës 10.12.2022 në shumë prej 36,580.12 € dhe atë në shumë prej 3,647.23 €. Rrjedhimisht, gjykata gjen se faturat në bazë të së cilave është lejuar përmbartimi i plotësojnë kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm dhe janë të përshtatshme për përmbartim

Gjykata Komerciale – dhomat e shkallës së dytë vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj konkludimin e shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe shkalla e dytë, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Bazuar në të lartë cekurat, dhoma e shkallës së dytë vlerëson se në rastin konkret faturat në bazë të së cilave është lejuar urdhri për përmbartim i plotësojnë kushtet për të qenë dokument i besueshëm dhe i përmbart te gjitha elementet e kërkuara dhe janë të përshtatshme për përmbartim, bazuar në dispozitat e nenit 29 par.3 dhe 37 të LPP-së.

Mbi bazën e kësaj dispozite ligjore, kjo Gjykatë vlerëson se dhoma e shkallës së parë ka konstatuar drejtë se faturat si dokument të besueshëm mbi të cilën ishte iniciuar procedura përmbartimore, respektivisht është lejuar përmbartimi i plotëson kushtet në mënyrë kumulative që duhet t'i ketë dokumenti i besueshëm. Në rastin konkret qartë rezulton se fatura e përmbart nënshkrimin e

pranuesit i cili është kusht esencjal mbi bazën e së cilës dokumenti i besueshëm fiton tipare të përmbareshmërisë së titullit ekzekutiv, mbi bazën e së cilës mund të konstatohet ekzistimi i detyrimit dhe pranimi si i tillë nga debitori. Së këndejmi, Gjykata thekson se me plotësimin e këtij kushti dokumenti i besueshëm mund ta ketë fuqinë e titullit përmbaresh sepse rezulton se debitori e ka pranuar detyrimin, prandaj dhe dokumentet e besueshme në raport me dokumentet tjera përmbaresh duhet ta kenë fuqinë e pa kontestuar ekzekutive në mënyrë që procedura përmbaresh të iniciohet përmes këtyre dokumenteve. Një veprim i tillë, për Gjykatën paraqet pranim të faturës dhe detyrimit.

Së këndejmi, edhe gjykata e shkallës së dytë është e qëndrimit të njëjtë juridik se në procedurën përmbaresh organi përmbaresh, përfshirë këtu edhe gjykatën që ka kompetencë shqyrtimin e ligjshmërisë së përmbareshit, nuk ka tagër të vlerësojë ligjshmërinë e raportit juridik nga i cili rrjedh dokumenti i besueshëm, statusin e palëve apo detyrimet endërsjella mes tyre. Por, organi përmbaresh, përfshirë edhe gjykatën e shkallës së parë shqyrton vetëm rregullsinë dhe përshtatshmërinë e dokumentit përmbaresh dhe/apo atij të besueshëm, me ç'rast procedura sipas prapësimit i nënshtrohet vetëm shqyrtimit formal të titullit ekzekutiv.

Andaj, duke marr parasysh pretendimet ankimore, të cilat konsistojnë ndaj aktvendimit të ankimit, Gjykata Komerciale e Kosovës - Dhoma e Shkallës së Dytë konsideron se këto pretendime ankimore janë të pa bazuara, ngase nuk kemi të bëjmë me shkelje thelbësore të dispozitave të Ligjit të Procedurës Kontestimore, dhe zbatimin të gabuar të drejtës materiale, të cilat shkelje kjo gjykatë i vështron sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, dhe as të Ligjit të Procedurës Përmbaresh.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 209 pika b) të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhoma e shkallës së dytë

K. DH.Shk II.nr. 155/24 me datë 16.04.2024

Gjyqtarja,

Saranda Bogaj Sheremeti